

KOMUNIKIM PËR SHTYP

Ecure pozitive e Bankës Emporiki Shqipëri - Crédit Agricole Group gjatë 3-mujorit të dytë të 2012-ës

Tiranë, 7 Gusht 2012 - Gjatë 3-mujorit të dytë për vitin 2012, Banka Emporiki Shqipëri – Crédit Agricole Group shënoi një përmirësim të dukshëm në rritjen e numrit të klientëve të depozitave. Ky rezultat i dedikohet veçanërisht përmirësimit të aktivitetit të Njesisë së Ndërmarrjeve dhe Retailit, duke përfshirë dhe përmirësimin në efikasitetin e rrjetit të degëve dhe promovimit të fuqishëm të emrit dhe brandit të ri të Grupit Crédit Agricole.

Niveli i kreditimit të klientelës ka qenë i kontrolluar, në përputhje me strategjinë e grupit nëpërmjet kujdesit të vazhdueshëm dhe duke mbajtur të ulët riskun për aktivitetin kreditues. Megjithatë, Banka Emporiki Shqipëri ka vazhduar të mbështesë segmente të ndryshme të klientelës së Retail dhe projekte të korporatave, veçanërisht në ato linja që janë në sinergji me Grupin.

Gjatë 3-mujorit të dytë 2012, Banka Emporiki Shqipëri – Crédit Agricole Group rriti kapitalin e saj, me qëllim ruajtjen dhe përmirësimin e mëtejshëm të treguesve të kapitalizimit, duke u fokusuar më shumë në Nivelin e Mjaftueshmërisë së Kapitalit.

Kostoja e riskut reflektoi një përqendrim gjatë 3-mujorit të dytë e ndikuar nga klima e vështirë ekonomike në Shqipëri, efekte këto të importuara nga vendet fqinje, të cilat edhe pse jo në mënyrë të konsiderueshme influencuan në rezultatin e të ardhurave neto të bankës.

Gjithsesi, Banka Emporiki Shqipëri – Crédit Agricole Group e mbylli aktivitetin e saj në Qershor 2012 me një rezultat pozitiv përse i përket të ardhurave operacionale bruto, të mbledhura gjatë 3-mujorit të dytë të vitit, ku pati impakt edhe zhvlerësimi i Euros përballë Lekut gjatë kësaj periudhe.

Në datë 14 Qershor '12 Crédit Agricole SA njoftoi firmosjen e një kontrate për blerjen e Bankës Emporiki Shqipëri nga zotëruesi i tij Grupi Emporiki Greqi. Ky proces është subjekt miratimi nga ana e Bankës së Shqipërisë. Pas përfundimit të kësaj procedure Banka Emporiki Shqipëri do të adoptojë emrin e Crédit Agricole, markën si dhe logon e grupit.

Kontakte:

Grupi Crédit Agricole është lider për Retail në Francë dhe një nga grupet bankare më të mëdha në Europë. Crédit Agricole synon t'i shërbejë ekonomisë duke mbështetur klientët në projekte të të gjitha fushave të retail banking dhe linjave të specializuara të biznesit.

Duke vënë në pah vlerat dhe angazhimin e tij, Crédit Agricole Group është banka e praktikitetit. Ajo ve në zemër të aktivitetit të saj interesin e 54 milion klientëve, 160,000 mije punonjësve, 1.2 milion aksionerëve dhe 6.5 milion aksionerëve të përbashkët.



Kontakte:

Mirela Xhelollari / Tel +355 2258 755 ext. 261 / E-mail: marketing@emporiki.com.al